

VENDIM
Nr. 4, datë 1.2.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 30, DATË 18.7.2017, “PËR
LICENCIMIN E SHA, UJËSJELLËS-KANALIZIME BERAT-KUÇOVË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence”(VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 1.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. (UK Berat-Kuçovë) sh.a., për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor,

VËREN SE:

1. Shoqëria UK Berat-Kuçovë me shkresën nr. 25 prot. datë 10.1.2019, me lëndë “Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit ligjor” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë së UK Berat-Kuçovë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. UK Berat-Kuçovë ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor me dokumentacionin si më poshtë:

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të UK Berat-Kuçovë nr. 178, datë 31.12.2018, “Për lirimin e administratorit të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”;

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të UK Berat-Kuçovë nr. 179, datë 31.12.2018 “Për emërimin e administratorit të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

- a) ERRU-ja ka licencuar shoqërinë UK Berat-Kuçovë, me vendimin nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e sh. a Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë”, i ndryshuar me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura;

- b) Asambleja e Përgjithshme e Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. me vendimin nr. 178, datë 31.12.2018, “Për lirimin e administratorit të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë” dhe vendimin nr. 179, datë 31.12.2018 “Për emërimin e administratorit të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë” ka vendosur ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë UK Berat-Kuçovë duke emëruar z. Pelivan Sinaj.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat-Kuçovë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Berat–Kuçovë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Berat–Kuçovë”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues ligjor: Pelivan Sinaj”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani